



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RAPORT MONITORIMI

“Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve”

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Periudha e monitorimit prill-maj 2019

Përmbajtja

Hyrje.....	4
BAZA LIGJORE	5
METODOLOGJIA	6
PREZANTIMI I GJETJEVE NGA MONITORIMI I LAJMEVE QENDRORE	9
RTK1	9
KTV	14
TV21.....	19
RTK2.....	24
TV Dukagjini.....	29
KLAN KOSOVA	34
TE7	39
PËRFUNDIM	44
REKOMANDIM.....	46

Përkufizimet

KPM – Komisioni i Pavarur i Mediave.

DMA – Departamenti i Monitorimit dhe Analizës i KPM-së.

OSHMA – Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizuel nënkupton personin fizik ose juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuale të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.

OSH – Operatori i shpërndarjes – personi juridik i cili shpërndan shërbime mediale audio dhe audio-vizuale për përdoruesit përmes rrjetit kabllor, IPTV, OTT, satelitor dhe çfarëdo forme tjetër të shpërndarjes jashtë brezit frekuencor radio-difuziv tokësor.

Hyrje

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, KPM-ja licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale, përfshirë këtu edhe aspektet që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim.

Politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM-ja duhet të jetë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare të transmetimit dhe të të drejtave të njeriut.

E drejta e lirisë së mendimit dhe të shprehjes, përfshirë lirinë e mbajtjes së mendimit pa ndërhyrje dhe për të kërkuar, pranuar dhe shpërndarë informacion dhe ide përmes mediave është e drejtë e garantuar edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara si dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Duke pas parasysh rolin e mediave në përgjithësi, që krahas zhvillimeve teknologjike sot janë të qasshme për publikun përmes kanaleve të shumta të komunikimit, e në veçanti ndikimin e lajmeve në të gjitha aspektet shoqërore në përgjithësi, është e nevojshme të kemi një pasqyrë të vlerësimit të lajmeve që i plasohen publikut nga ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale në Kosovë.

Lidhur me këtë, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës së KPM-së ka realizuar monitorimin e lajmeve qendrore të ofruara nga të licencuarit e saj gjatë muajit prill dhe maj të vitit 2019, me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të përmbajtjeve që ofrohen për qytetarët e Kosovës.

BAZA LIGJORE

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, përkatësisht nenit 9, përcaktohet se:

“Politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM-ja duhet të jetë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare të transmetimit dhe të të drejtave të njeriut, legjislacionin përkatës të BE-se e në veçanti me Direktivën e Komisionit Evropian AVMS duke respektuar plotësisht demokracinë dhe sundimin e ligjit si dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes”.

“Politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM-ja, duhet të reagojë në të drejtën e publikut për të ditur dhe për t’u njoftuar përmes promovimit të programeve të sakta dhe informative”.

Sipas Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë të KPM-së, respektivisht nenit 6, përcaktohet se:

Paragrafi 1 *“OSHM-të duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t’i paraqesin ato në mënyrë të paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë material për të cilin e dinë ose duhet të dinë se është i pavërtetë ose mashtrues”.*

Paragrafi 2 *“OSHM-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërtënieve politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ”.*

Paragrafi 4 *“Përderisa OSHM-të janë të lirë për të shprehur opinionet e tyre, ata duhet të bëjnë dallimin e qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit. Lajmi është informacion i përbërë nga faktet dhe të dhënat, ndërsa opinioni mbart mendimet, idetë, besimet, supozimet, komentet apo gjykimet vlerësuese”.*

Paragrafi 7 *“OSHM-të duhet të ofrojnë prezantim të perspektivave të ndryshme në mënyrë korrekte dhe të drejtë. Në qoftë se njëra palë refuzon që të ofrojë pikëpamjen e saj, publiku duhet të informohet për këtë refuzim”.*

Paragrafi 8 *“OSHM-të duhet të bazohen në burime të identifikueshme të informacionit dhe duhet të jenë të përkushtuar për të mbrojtur identitetin e atyre që japin informacion në besim, pa marrë parasysh se a kërkohet kjo paraprakisht apo jo”.*

METODOLOGJIA

Me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të përmbajtjeve të ofruara përmes edicioneve informative të lajmeve qendrore është përdorur metodologjia e kombinuar, kuantitative dhe kualitative.

Fillimisht janë grumbulluar të dhënat statistikore nga subjektet e hulumtimit dhe më pas ato janë kategorizuar dhe përpunuar për arritjen e rezultateve të sakta dhe prezantimin vizual të rezultateve. Mjetet e punës që janë shfrytëzuar për këtë monitorim janë: sistemi i monitorimit, i cili ka mundësuar qasje dhe ruajtje të përmbajtjes programore të subjekteve të këtij monitorimi, për matje, analizim edhe vlerësim.

Vlerësimi i përmbajtjeve të edicioneve qendrore të lajmeve është bërë nga zyrtarët monitorues të DMA-së, për periudhën kohore dy (2) mujore, duke përfshirë muajin prill dhe maj të vitit 2019.

Mostra e monitorimit përfshinë 7 OSHMA, prej tyre:

- 3 OSHMA me mbulim tokësor nacional (RTK1, TV21 dhe KTV);
- 1 OSHMA me mbulim tokësor lokal (TV Dukagjini); dhe
- 3 OSHMA që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Klan Kosova dhe TE7).

Për nxjerrjen e të dhënave sa i përket hapësirës së dhënë për kategoritë e përcaktuara është përdorur metoda kuantitative duke matur me sekonda kohën e dhënë në kronika/tema.

Përmbajtja e monitoruar është ndarë sipas kategorive/temave dhe nënkategorive në vijim:

1. Politikë, që ka përfshirë veprimtarinë e:

Presidentit - aktiviteti/kronika ku është i përfshirë Presidenti si protagonist (intervistë, prononcim/deklaratë e drejtpërdrejt apo përmes komunikatave për media/rnjete sociale, vizita, takime etj..).

Presidencës - kronika që përfshinë aktivitetet e zhvilluara në kuadër të Zyrës së Presidentit, p.sh. këshilltarët etj.

Kryeministrit - aktiviteti/kronika ku është i përfshirë Kryeministri si protagonist; (intervistë, prononcim/deklaratë e drejtpërdrejt apo përmes komunikatave për media/rnjete sociale, vizita, takime etj..).

Qeverisë - kronika që përfshinë aktivitetet e zhvilluara në kuadër të qeverisë në përgjithësi, p.sh. zëvendësit apo pjesëtarët e kabinetit si p.sh. këshilltarët/ apo agjenci në kuadër të Zyrës së KM-së, ministritë, duke përfshirë aktivitetet në të cilën janë të përfshirë Ministri/zv.Ministri, apo pjesëtarë të kabinetit të ministrisë përkatëse.

Kryetarit të Kuvendit - aktiviteti/kronika ku është i përfshirë Kryetari i Kuvendit si protagonist;

Kuvendit të Kosovës - kronika që përfshinë aktivitetet (mbledhjet/takimet/vizitat etj.) e anëtarëve të Kryesisë, anëtarëve të komisioneve të Kuvendit, kronika nga seancat e Kuvendit, etj.

Subjekteve politike - aktiviteti/kronika në të cilën përfshihen aktivitetet e subjektit të caktuar politik, p.sh. konferencat për media, aktivitetet partiake, deklaratatë drejtpërdrejta apo përmes rrjeteve sociale, intervista etj.

Tjera - aktiviteti/kronika në të cilën përfshihen aktivitetet e institucioneve/organizatave tjera të pavarura, organizata ndërkombëtare, ambasada të Kosovës apo të vendeve të huaja etj. në çështjet që ndërlidhen me zhvillimet politike në vend.

2. Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik:

Çështje të përgjithshme ekonomike - lidhur me të ardhurat në nivel nacional, konsumi dhe investimet, inflacioni, GDP, çmimet, kursimet rritja e tregut, papunësia, konkurrenca, etj..

Bujqësi - tema lidhur me bujqësi në përgjithësi.

Industri/prodhimtari - tema lidhur me industri/prodhimtari në përgjithësi.

Tjera – nënkategori të tjera të papërfshira më sipër, që ndërlidhen me aspektin ekonomik.

3. Kategori të tjera të sferave të caktuara, ka përfshirë fusha si:

Drejtësia/Sundim i Ligjit – aktivitetet/kronika që trajtojnë tema në fushën e drejtësisë, sundimin e ligjit në përgjithësi, respektimin e parimeve të epërsisë së ligjit, barazisë para ligjit, llogaridhënies ndaj ligjit, drejtësisë në zbatimin e ligjit, ndarjes së pushteteve, pjesëmarrjes në vendimmarrje, sigurisë juridike, etj..

Siguria - aktivitetet/kronika që trajtojnë tema në fushën e sigurisë në përgjithësi (aktivitetet lidhur me mbrojtjen e territorit, qytetarëve kundër kërcënimeve për mirëqenien e tyre dhe për prosperitetin e komuniteteve të tyre (Ushtria, Policia, Zjarrfikësit, AKI dhe agjenci tjera të sigurisë), duke përfshirë zbatimin e ligjit, zjarrin, urgjencën mjekësore, ngjarjet që mund të rrezikojnë sigurinë e publikut të gjerë nga rreziqet e ndryshme, terrorizmi, dëmtimi ose dëmtimi i pronës, krimi i organizuar (përdorimi i narkotikëve, vjedhje, vrasje, etj.), komunikacion, fatkeqësitë natyrore ose të bëra nga njeriu.

Sociale- tema/kronika që trajtojnë tema shoqërore në përgjithësi.

Art/Kulturë/Edukim - tema/kronika që trajtojnë tema nga arti, kultura dhe arsimi.

Shëndetësi - tema/kronika që trajtojnë tema nga shëndetësia.

Tjera – nënkategori të tjera të papërfshira në nënkategoritë më sipër.

4. Lajmet ndërkombëtare, janë ndarë në tri nënkategori:

Rajon – temat nga rajoni përfshirë: Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Serbinë.

Evropë - kronika që trajtojnë tema rreth ngjarjeve në vendet evropiane.

Botë – kronika që trajtojnë tema rreth ngjarjeve në Botë (duke përjashtuar Evropën).

5. Sport:

Vendor - duke përfshirë lajme dhe kronika rreth ngjarjeve sportive në vend.

Ndërkombëtar – duke përfshirë lajme dhe kronika rreth ngjarjeve sportive në arenën ndërkombëtare.

Ndërsa, metoda kualitative është përdorur për të vlerësuar nëse lajmet e transmetuara në kronika kanë qenë relevante (mbulim i ngjarjeve/temave të kohës), janë transmetuar me saktësi (përmbajta bazuar në informata dhe fakte të verifikuara saktë), nëse është siguruar mbulim i balancuar i çështjeve me interes publik (dy ose më shumë palë të përfshira në temën/kronikën për çështje të caktuara) si dhe është bërë vlerësimi për mënyrën e prezantimit të kronikës dhe trajtimi nga gazetari/ reporteri/ mediumi, përfshirë paanshmërinë në zgjedhjen e gjuhës dhe imazheve.

Sa i përket raportit gjinor, është përcaktuar që të nxirren të dhëna sasiore sa i përket numrit të moderimit/udhëheqjes dhe editimit/redaktimit të lajmeve në bazë të gjinisë si dhe hapësirës së dhënë në kategorinë e sportit sipas gjinisë.

PREZANTIMI I GJETJEVE NGA MONITORIMI I LAJMEVE QENDRORE


RTK1

Në bazë të monitorimit të lajmeve qendrore të Radio Televizionit të Kosovës (RTK1) të orës 19:30 për periudhën monitoruese 01 prill deri më 31 maj 2019, në përgjithësi lajmet kanë qenë relevante dhe kanë mbuluar ngjarjet kryesore të ditës dhe kryesisht ngjarjeve politike që kanë të bëjnë me vendin. Raportimet janë bazuar në burime të sakta të informacionet dhe kanë qenë të balancuar duke përfshirë dy apo më shumë palë dhe/apo burime të përfshira në ngjarjen e raportuar. Ndërkaq, sa i përket konotacionit gjatë raportimit, prezantimi në përgjithësi ka qenë neutral.

Periudha monitoruese: 01-30 prill 2019

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që RTK1 i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 44.71%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 2.01%, kategori të tjera të sferave të caktuara 41.15%, lajme ndërkombëtare 10.94% dhe sport 1.19%.

RTK1



Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 44.71%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 5.59%
- Presidenca 0.29%
- Kryeministri 6.04%
- Qeveria 11.13%
- Kryetari i Kuvendit 3.11%
- Kuvendi 3.40%
- PDK 1.59%
- LDK 1.13%
- LVV 2.54%
- AAK 0.81%
- PSD 1.62%
- NISMA 0.34%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 7.12%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 2.01%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 0.68%
- Bujqësi 0.50%
- Industri-prodhimtari 0.33%
- Tjera 0.50%.

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 41.15%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 8.23%
- Siguri 5.26%
- Sociale 14.45%
- Art/Kulturë/Edukim 7.78%
- Shëndetësi 1.17%
- Tjera 4.26%.

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 10.94%, prej tyre:

- Rajon 5.16% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Maqedoninë e Veriut, Serbi e Mal të Zi.
- Evropë 0.94% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Britani e Madhe, Turqi, Spanjë, Rusi dhe Francë.
- Botë 4.84% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: SHBA, Shri Lankë, Indonezi, Indi, Pakistan, Etiopi, Ruandë, Brunei dhe Kore e Veriut.

Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 1.19% dhe atë vetëm tema që kanë të bëjnë arritjen e sportistëve kosovar në arenën ndërkombëtare dhe mbajtja e gjysmë maratonës në Prishtinë.

Raporti gjinor në prezantim dhe redaktim të lajmeve si dhe sportit në edicione të lajmeve


Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 36.67% nga femrat kurse 63.33% nga meshkujt. Ndërkaq, redaktimi i lajmeve është bërë 33.33% nga femrat dhe 66.67% nga meshkujt.

Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (1.19% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 61.50%, ndërsa për meshkuj hapësirë prej 38.50%.

Periudha monitoruese: 01-31 maj 2019

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit kjo është hapësira që RTK1 i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 52.41%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 3.50%, kategori të tjera të sferave të caktuara 32.54%, lajme ndërkombëtare 11.11% dhe sport 0.44%.

RTK1



Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për kategori ka qenë në sasi prej 52.41%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 5.50%
- Presidenca 0.37%
- Kryeministri 5.54%
- Qeveria 8.84%
- Kryetari i Kuvendit 4.99%
- Kuvendi 6.42%
- PDK 2.52%
- LDK 4.05%
- LVV 1.35%
- AAK 0.22%
- PSD 0.14%
- NISMA 0.09%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 12.38%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 3.50%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 3.05%
- Tjera 0.45%.

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 32.54%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 4.46%
- Siguri 5.20%
- Sociale 16.11%
- Art/Kulturë/Edukim 4.11%
- Shëndetësi 0.52%
- Tjera 2.14%.

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 11.11%, prej tyre:

- Rajon 6.52% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.
- Evropë 1.60% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Austri, Britani e Madhe, Norvegji, Ukrainë dhe zgjedhjet në Parlamentin e BE-së.
- Botë 2.99% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Venezuelë, Iran, Kinë, SHBA, Jemen, Australi, Egjipt, Indonezi, Izrael, etj.

Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 0.44% dhe atë vetëm në sporte kolektive siç është futbollit. Sa i përket hapësirës së sportit, e tëra i dedikohet sportit vendor.

Raporti gjinor në prezantim dhe redaktim të lajmeve si dhe sportit në edicione të lajmeve

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 58.06% nga femrat kurse 41.94% nga meshkujt. Ndërkaq, redaktimi i lajmeve është bërë 29.03% nga femrat dhe 70.97% nga meshkujt.

Ndërsa sa i përket sportit, e tërë hapësira e dedikuar për këtë kategori i është kushtuar sportit për meshkuj.


KTV

Në bazë të monitorimit të lajmeve qendrore të orës 19:00, për periudhën monitoruese dymujore nga data 01 prill deri më 31 maj 2019, në përgjithësi lajmet kanë qenë relevante dhe kanë mbuluar ngjarjet kryesore të ditës dhe ato kryesisht politike rreth ngjarjeve që kanë të bëjnë me vendin. Raportimet janë bazuar të burime të sakta të informacionet dhe kanë qenë të balancuar duke përfshirë dy apo më shumë palë të përfshira në ngjarjen e raportuar dhe prezantimi në përgjithësi ka qenë neutral sa i përket konotacionit gjatë raportimit.

Periudha monitoruese: 01-30 prill 2019

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit në KTV është dhënë kjo hapësirë për kategoritë e mëposhtme: politikë 36.64%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 1.15%, kategori të tjera të sferave të caktuara 47.30%, lajme ndërkombëtare 14.20% dhe sport 0.71%.

KTV



Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për kategori ka qenë në sasi prej 36.64%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 2.52%
- Kryeministri 3.96%
- Qeveria 2.63%
- Kryetari i Kuvendit 0.41%
- Kuvendi 4.31%
- PDK 0.43%
- VV 3.47%
- PSD 0.85%
- AKR 0.29%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 17.77%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjet që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve është dhënë hapësirë prej 1.15%, prej tyre:

- Bujqësi 0.34%
- Tjera 0.81%.

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 47.30%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 7.08%
- Siguri 3.40%
- Sociale 14.08%
- Art/Kulturë/Edukim 4.73%
- Shëndetësi 2.96%
- Tjera 15.05%.

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 14.20%, prej tyre:

- Rajon 1.53% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Greqi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi.

- Evropë 0.73% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Turqi, Irlandë, Itali, Spanjë, Britani e Madhe, Rusi, Francë dhe Sllovaki.
- Botë 11.94% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: SHBA, Libi, Kinë, Izrael, Palestinë, Japoni, Kanada, Brazil, Ruandë, Brunei, Kore e Veriut, Etiopi, Ekuador, Egjipt, Shri Lankë, Indonezi, Indi, Pakistan dhe Jemen.

Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 0.71% dhe atë vetëm tema që kanë të bëjnë me sportin vendor apo arritjeve të sportistëve kosovar në arenën ndërkombëtare dhe ka përfshirë tema rreth disiplinave: futboll (meshkuj) dhe xhudo (femra).

Raporti gjinor në prezantim dhe redaktim të lajmeve si dhe sportit në edicione të lajmeve


Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë vetëm nga prezantues femra, ndërsa redaktimi i lajmeve është bërë vetëm nga meshkujt.

Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (0.71% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 25.28%, ndërsa për meshkuj hapësirë prej 74.72%.

Periudha monitoruese: 01-31 maj 2019

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit në KTV është dhënë kjo hapësirë për kategoritë e mëposhtme: politikë 32.47%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 2.29%, kategori të tjera të sferave të caktuara 48.01%, lajme ndërkombëtare 16.50% dhe sport 0.73%.

KTV



Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për kategori ka qenë në sasi prej 32.47%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 1.75%
- Kryeministri 2.02%
- Qeveria 2.87%
- Kryetari i Kuvendit 1.89%
- Kuvendi 4.05%
- PDK 1.68%
- LDK 1.71%
- VV 1.90%
- PSD 0.67%
- NISMA 0.12%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 13.81%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjet që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve është dhënë hapësirë prej 2.29%, prej tyre:

- Bujqësi 0.34%
- Tjera 1.95%.

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 48.01%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 8.64%
- Siguri 5.83%
- Sociale 7.93%
- Art/Kulturë/Edukim 5.13%
- Shëndetësi 2.15%
- Tjera 18.33%.

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 16.50%, prej tyre:

- Rajon 2.79% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Maqedoni të Veriut dhe Serbi.
- Evropë 5.74% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Turqi, Irlandë, Itali, Spanjë, Britani e Madhe, Rusi, Hungari, Francë dhe Austri.
- Botë 7.97% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: SHBA, Kinë, Izrael, Palestinë, Japoni, Kanada, Brazil, Kore e Veriut, Meksikë, Indonezi, Zelanda e Re dhe Venezuelë.

Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 0.73% dhe atë vetëm tema që kanë të bëjnë me sportin vendor apo arritjeve të sportistëve kosovar në arenën ndërkombëtare dhe ka përfshirë vetëm tema rreth futbollit për meshkuj.

Raporti gjinor në prezantim dhe redaktim të lajmeve si dhe sportit në edicione të lajmeve

Në periudhën e monitoruar nga data 01 deri me 31 maj 2019, prezantimi i lajmeve është bërë kryesisht nga prezantuese femra me rreth 87.10% dhe meshkuj me rreth 12.90%. Ndërsa, redaktimi i lajmeve është bërë vetëm nga meshkujt. Sa i përket sportit, nga hapësira e përgjithshme prej 0.73% e sportit, e tërë hapësira i dedikohet sportit për meshkuj.


TV21

Edicioni qendror i lajmeve të TV21 gjatë periudhës monitoruese, nga data 01 prill deri më 31 maj 2019, ka përfshirë lajme të cilat ishin relevante kryesisht me ngjarjet kryesore të ditës, qofshin ato politike dhe të fushave të tjera. Burimi i lajmeve të TV 21 ishte i saktë dhe lajmet përfshinin dy ose/edhe me shumë palë të përfshira në ngjarje. Prezantimi i lajmeve ishte neutral.

Periudha monitoruese: 01-30 prill 2019

Gjetjet e monitorimit tregojnë se TV21 në edicionin qendror të lajmeve të TV 21 ka ndarë hapësirë për kategoritë ashtu siç vijon: politike 38.65%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 3.44%, kategori të tjera të sferave të caktuara 31.85%, lajme ndërkombëtare 21.15% dhe sport 4.91%.

TV 21



Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për kategorinë politike ka qenë në sasi prej 38.65%, ndërsa nënkategoritë tjera me hapësirë përkatëse janë:

- Presidenti 2.23%
- Kryeministri 6.47%
- Qeveria 6.46%
- Kryetari i Kuvendit 1.19%

- Kuvendi 3.55%
- PDK 0.08%
- LDK 0.58%
- VV 2.62%
- AAK 0.18%
- PSD 0.70%
- NISMA 0.03%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 14.56%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjet që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve është dhënë hapësirë prej 3.44%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 1.91%
- Bujqësi 0.54%
- Tjera 0.99%

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 31.85%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 1.84%
- Siguri 1.51%
- Sociale 10.06%
- Art/Kulturë/Edukim 7.07%
- Shëndetësi 0.99%
- Tjera 10.38%.

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 21.15%, prej tyre:

- Rajon 6.96% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Serbi.
- Evropë 3.82% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera në: Britani e Madhe, Francë, Finlandë, Irlandë, Vatikan dhe Spanjë.

- Botë 10.37% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: SHBA, Palestinë, Japoni, Kanada, Brazil, Brunei, Kore e Veriut, Etiopi, Ekuador, Egjipt, Shri Lankë, Indonezi, Indi, Pakistan etj..

Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 4.91% tema që kanë të bëjnë me sportin vendor si dhe ndërkombëtar, arritjeve të sportistëve kosovar në arenën ndërkombëtare. Kryesisht janë përfshirë tema rreth disiplinave: futboll (meshkuj dhe femra) vendor dhe ndërkombëtar, basketboll (meshkuj) vendor (4.33%) dhe ndërkombëtar (0.58%) dhe më pak disiplina tjera.

Raporti gjinor në prezantim dhe redaktim të lajmeve si dhe sportit në edicione të lajmeve

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë nga rreth 70% moderatore femra dhe 30% meshkuj, kurse redaktimi i lajmeve është bërë vetëm nga gjinia femërore.


Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (4.77% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 11.36%, ndërsa për meshkuj hapësirë prej 88.64%.

Periudha monitoruese: 01-31 maj 2019

Për shkak të mungesës së sinjalit në sistemin e monitorimit, në monitorim nuk janë përfshirë përmbajtjet e transmetuara më datën 6, 16, 21 dhe 23 maj 2019.

Gjetjet e monitorimit tregojnë se TV21 në edicionin qendror të lajmeve ka ndarë hapësirë për kategoritë ashtu siç vijon: politike 44.00%; ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 5.41%; kategori të tjera, të sferave të caktuara 32.56%; lajme ndërkombëtare 10.61% dhe sport 7.42%.

TV 21



Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për kategorinë politikë ka qenë në sasi prej 44.00%, ndërsa nënkategoritë tjera me hapësirë përkatëse janë:

- Presidenti 5.40%
- Presidenca 0.19%
- Kryeministri 5.64%
- Qeveria 5.52%
- Kryetari i Kuvendit 2.44%
- Kuvendi 4.95%
- PDK 1.10%
- LDK 2.11%
- VV 1.19%
- AAK 0.65%
- PSD 0.44%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 14.37%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjet që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve është dhënë hapësirë prej 5.41%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 3.94%
- Bujqësi 0.65%
- Tjera 0.82%.

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 32.56%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 3.37%
- Siguri 5.92%
- Sociale 7.99%
- Art/Kulturë/Edukim 9.66%
- Shëndetësi 0.79%
- Tjera 4.83%.

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 10.61%, prej tyre:

- Rajon 5.61% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Serbi.
- Evropë 1.36% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera në: Britani e Madhe, Vatikan, Francë, Lituani, Turqi, Rusi dhe Austri.
- Botë 3.64% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: SHBA, sanksionet e SHBA ndaj Iranit, etj.

Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 7.42% tema që kanë të bëjnë me sportin vendor si dhe ndërkombëtar, arritjeve të sportistëve kosovar në arenën ndërkombëtare. Kryesisht janë përfshirë tema rreth disiplinave: futboll (meshkuj dhe femra) vendor dhe ndërkombëtar, basketboll (meshkuj) vendor (6.74%) dhe ndërkombëtar (0.68%) dhe më pak disiplina tjera.

Raporti gjinor në prezantim dhe redaktim të lajmeve si dhe sportit në edicione të lajmeve

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë nga rreth 63.33% moderatore femra dhe 36.67% meshkuj, kurse redaktimi i lajmeve është bërë vetëm nga gjinia femërore.

Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (7.42% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 10.15%, ndërsa për meshkuj hapësirë prej 89.85%.


RTK2

Në bazë të monitorimit të lajmeve për periudhën monitoruese, nga data 01 prill deri më 31 maj 2019, në përgjithësi lajmet kanë qenë relevante dhe kanë mbuluar ngjarjet kryesore të ditës dhe ato kryesisht politike rreth ngjarjeve që kanë të bëjnë me vendin. Raportimet janë bazuar të burime të sakta të informacionet dhe kanë qenë të balancuar duke përfshirë dy apo më shumë palë të përfshira në ngjarjen e raportuar dhe prezantimi në përgjithësi ka qenë neutral sa i përket konotacionit gjatë raportimit.

Periudha monitoruese: 01-30 prill 2019

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit në RTK2 është dhënë kjo hapësirë për kategoritë e mëposhtme: politikë 36.65%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 4.22%, kategori të tjera të sferave të caktuara 30.91%, lajme ndërkombëtare 18.13% dhe sport 10.09%.

RTK 2



Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për kategorinë politikë ka qenë në sasi prej 36.65%, ndërsa nënkategoritë tjera me hapësirë përkatëse janë:

- Presidenti 1.59%
- Presidenca 0.17 %
- Kryeministri 4.16%
- Qeveria 4.54%
- Kryetari i Kuvendit 0.07%
- Kuvendi 2.04%
- PDK 0.21%
- LDK 0.29%
- VV 0.49%
- AAK 0.10%
- SLS 1.05%
- SL 1.2%
- SDP 0.41%
- ALTERNATIVA 0.09%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 20.24%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjet që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve është dhënë hapësirë prej 4.22%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 2.99%
- Bujqësi 1.23%.

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 30.91%, prej tyre:

